



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:238859

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05490590

P.nr.313/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit A.M, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par. 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1707/22 të datës 10.11.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **14.02.2024**, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, përfaqësuesit të dëmtuarës Komuna Istog, Adem Avdijaj dhe të pandehurit A.M, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 11.03.2024 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.M, nga i ati R. dhe e ëma Z. e gjinisë D., i lindur me datë ...në fshatin D., tani me vendbanim në fshatin B. rr. “Lidhja e P.” Komuna Is. i martuar, babai i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, pensionist, me gjendje të mesme ekonomike, me nr. personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Nga data 24.08.2022 e në vazhdimësi, në rr. ”Lidhja e P.” në fshatin B. Komuna e I., në mënyrë të kundërligjshme uzurpon një pjesë të pronës së paluajtshme, pronë e ujërave publike të Komunës së Istogut, në atë mënyrë që i pandehuri në afërsi të shtëpisë së tij, fillimisht ka vendosur gurë dhe me pas në një pjesë ka rrafshuar me zhavor, të cilën paluajtshmeri e shfrytëzon për shitjen e gurëve, për çka edhe e pohon një fakt të tillë.

- me çka ka kryer veprë penale **uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 69, 81, 82 të KPRK-së dhe nenet 242, 369, 498 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

- I. Të pandehurit **A.M**, më këtë vërejtje gjyqësore i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale, dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksionin me të rëndë penal.
- II. **URDHEROHET** i pandehuri A.M, që të bëj kompensimin e humbjes apo dëmit, përkatësisht t'a liroj nga njerëzit dhe sendet pronën e paluajtshme të cilën e ka uzurpuar nga e dëmtuara Ujrat Publike në Komunë Istog, dhe atë parcelën lëndore në Zonën Kadastrale në Baicë, sipërfaqen prej 248m² nga pjesa e njësisë kadastrale 443-0. Në afat kohorë prej një (1) muaji, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.
- III. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **njëzet (20) euro**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. **Pala e dëmtuar:** Komuna Istog, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1707/22 të datës 10.11.2022, kundër të pandehurit A.M për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 14.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, përfaqësuesi i të dëmtuarës KK Istog-Adem Avdijaj dhe i pandehuri A.M, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri A.M ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këtë veprim dhe i premtom

gjykatës që në të ardhmen do të ketë sjellje të mira, nuk do të kryej vepra penale dhe do të bëjë largimin e sendeve të vendosura në pronën lëndore.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit A.M, i njëjti pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresë të lëndës. I propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe si rrethanë rënduese fillimisht të verifikohet e kaluara e tij kriminale dhe në rast se i njëjti ka kryer vepra penale dhe është dënues me aktgjykim të formës së prerë para kryerjes së kësaj vepre penale të merret si rrethanë rënduese ndërsa si rrethanë lehtësuese të marr pranimin e fajësisë si dhe gatishmërinë për të mënjeluar pengesat e vendosura në pronën lëndore.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës Komuna Istog, Adem Avdijaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, mirëpo në rast se i pandehuri i largon sendet e vendosura në pronën lëndore brenda afatit të cilit ia cakton gjykata, nëse si palë e dëmtuar pastaj nuk do të paraqesim kërkesë pasurore juridike.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata në rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për të cilën është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana**

lehtësuese ka gjetur: se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, nuk ka qenë i dënuar me parë dhe rrethanat personale se është i moshës së shtyer, është penduar për veprën penale të kryer si më lart dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe do ti largoj sendet e vendosura ne pronën lëndore të uzurpuar, ndërsa **rrethana rëndues** nuk ka gjetur. Andaj në mungesë të rrethanave rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, dhe duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, të pandehurit konform të neneve 81 dhe 82 të KPRK-së i shqiptoj vërejtje gjyqësore me bindjen se në rastin konkret edhe me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit, që i njëjti në të ardhmen të përmbahet nga kryerja e veprave penale.

Urdhëri për lirim të pronës së uzurpuar

Gjykata konform nenit 61 të KPRK-së, e urdheroi të pandehurin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që t'a liroj pronën lëndore të uzurpuar dhe nga e njëjta të largoj gjitha sendet, përkatësisht me këtë veprim të kompensoi humbjen apo demin e shkaktar ndaj palës së dëmtuar të cilës i'a ka pamundësuar shfrytëzimin e lirshëm të pronës lëndore në periudhën kohore të përcaktuar në përshkrimin faktik të veprës penale e cila i vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës të precizuara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*